



Republika e Kosovës
Republika Kosovo–Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 91/2012
Prishtinë, më 17.01.2013, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C–203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti – kryetar, Teuta Sahatqija, Fikrim Damka, Sala Berisha – Shala, Lutfi Zharku, Hashim Dëshishku, Visar Ymeri dhe Myzejene Selmani,

Munguan: Berat Buzhala, Ramiz Kelmendi dhe Biserka Kostiq.

Pjesëmarrës të tjerë: Ramadan Sejdiu dhe Shahe Kukaj- MZHE/NJPMNI; Burim Ejupi – INDEP; Agron Demi dhe Visar Rushiti – GAP; Isuf Zejna – KDI; dhe Fitim Gashi – Kosova Sot – gazetar.

Stafi mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina dhe Besim Haliti.

Mbledhjen e kryesoi: Zenun Pajaziti, kryetar i komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Shqyrtimi i Raportit të performancës së ndërmarrjeve publike për vitin 2011

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua u miratua pa vërejtje.

1. Shqyrtimi i Raportit të performancës së ndërmarrjeve publike për vitin 2011

Kryetari - Tha se nga mbledhja e kaluar jemi pajtuar që të shqyrtohet sot “Raporti për performancën e ndërmarrjeve publike për vitin 2011”, së bashku me Komisionin për mbikëqyrjen e financave, mirëpo, ne kemi marr informacion nga ai komision se mbledhja e caktuar për sot është afati i shkurtër për ta, sepse ata kanë nevojë të përgatiten për ta shqyrtuar këtë raport. Ai propozoi që ne ta shqyrtojmë sot si komision dhe të procedojmë tutje.

Ramadan Sejdiu – Ministria e zhvillimit ekonomik - Njësia për Politika dhe Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike - Tha se Raporti është përpiluar nga të dhënat e ndërmarrjeve publike, zyra rregullative dhe raporteve të auditorëve të jashtëm, për të paraqitur një pikëpamje të qartë të performancës dhe perspektivës në sektorin e ndërmarrjeve publike. Gjithashtu, ky raport është përpiluar për të paraqitur tek Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe publiku çështjet me të cilat përballet niveli i tanishëm i shërbimeve dhe zhvillimet, që pasojnë për të përmirësuar qeverisjen korporative në sektor. NJPMNP-ja në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, e cila ka detyrë ligjore të monitorojë dhe raportojë për performancën individuale dhe sektoriale të NP-ve, e ka përgatitur këtë raport, i cili fokusohet në: performancën operative, sipas sektorëve dhe sipas ndërmarrjeve publike qendrore; performancën financiare, sipas sektorëve dhe sipas ndërmarrjeve publike qendrore; funksionimin e qeverisjes korporative; dhe vizionin, misionin, objektivat dhe projektet e ndërmarrjeve publike qendrore.

Deputetët **Teuta Sahatqija, Myzejene Selmani, Visar Ymeri dhe Hashim Deshishku** paraqitën komente dhe pyetje për raportin dhe përfaqësuesin e ministrisë.

Pas debatit më gjashtë (6) vota Për, një (1) votë Kundër, Komisionit nxori këtë

Përfundim

Miratohet Raporti i performancës së ndërmarrjeve publike për vitin 2011

Dhe, Kuvendit i paraqet këtë

Rekomandim

Të miratohet Raporti i performancës së ndërmarrjeve publike për vitin 2011.

Pjesë e këtij procesverballi është transkripti (datë 17.1.2013).

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Zenun Pajaziti

Kryetar i Komisionit



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI,
TË MBAJTUR MË 17.01. 2013**

**JANAR
2013**

E enjte, më 17. 01. 2013

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, zoti Zenun Pajaziti,

KRYETARI: Faleminderit! Nëse pajtoheni kishim filluar takimin. Faleminderit të nderuar kolegë deputet për pjesëmarrjen. Tani më siç u pajtuam në mbledhjen e kaluar që me e shty për sot këtë pikë të rendit të ditës në mënyrë që me i ftua edhe Komisionin tjetër që ka shpreh interesim bashkërisht me trajtua pikën që ka të bëjë me Raportin e performancës të ndërmarrjeve publike për vitin 2011. Me qenë se përgjigja e tyre paska qenë, tash e morra vesh që koha e shkurt edhe ata nuk kanë mund raportin me e trajtua. Atëherë unë kërkoj që ne të procedojmë me trajtimin e këtij raporti me qenë se jemi të pranishëm sot anëtarët e komisionit dhe po ashtu përfaqësuesi i drejtuesit të Njesisë për Menaxhimin e Ndërmarrjeve Publike në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë.

Kisha kërkuar formalisht miratimin e rendit e pastaj me fillua me punë. Kush është për. Kundër nuk ka. Faleminderit!

Me qenë se ne raportin e kem, e keni të gjithë ju. megjithatë rendi është që përfaqësuesi i Ministrisë me e bë prezantimin e raportit. Kisha kërkuar që vetëm shkurtimisht zoti Ramadan në pikat që ju ja merr mendja përveç asaj që ose diçka ju dëshironi me theksua që është në raport, kisha lutë me bë si prezantim e pastaj me marrë fjalën deputetë. Faleminderit, shumë! Fjalën e keni ju. Për shkak të incizimit prezantimi është i nevojshëm.

RAMADAN SEJDIU: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë jam Ramadan Sejdiu, udhëheqës i Njesisë për politika dheë monitorim të ndërmarrjeve publike. Shoqërona nga analistja, kolegja analistja në Njësine për politika dhe në Ministri të Zhvillimit Ekonomik, zonjusha Shahe Kukaj.

Të nderuar zotëri deputetë të Kuvendit,

Të nderuar të tjerë,

Kam nderë që në emër të ministrit dhe në emër të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik të paraqes për shqyrtim propozim Raportin mbi performancën e ndërmarrjeve publike në vitin 2011.

Siç e dini sipas nenit 8 të Ligjit për ndërmarrjet publike kërkohet të raportohet në baza vjetore në Kuvend dhe përformancën e sektorit dhe ky është raport që do të shqyrtohet nga ju dhe më pastaj është e juaja a do ta procedoni në Kuvend. Ky raport mban edhe të dhënat e vitit 2010 dhe 2011 dhe që tregojnë për përformancën e ndërmarrjeve publike të vitit 2011. Raporti është shqyrtuar në fillim, dua ta theksoj që në fillim se ky raport është i punuar në bazë, duke u bazuar në tri të dhënat e tri institucioneve domethënë e raportit vjetor për ndërmarrjet publike dhe në raportet e zyrave rregullative dhe në raportet e auditorit të jashtëm.

Aty ku kemi pas mospërputhje kredibile janë marrë raportet apo të dhënat nga raportet e institucioneve kredibile ... në zyrat rregulative dhe raportet e auditorit të jashtëm. Ngase shpeshherë ndërmarrjet publike e dinë me i zbuluar ato nga pakë. Dua ta theksoj se ky raport duket i vonuar nga fakti se kemi pasur zbrastirë në Ligjin bazikë sipas të cilit nuk përcaktohen se kur duhen fillimisht të auditohen pasqyrat financiare të ndërmarrjeve publike. Dhe duhet të ju informon se raportin e fundit të audituar të ndërmarrjeve publike e kem marrë me gjithë insistimet tona, kërkesat në fund të ngushtit.

Gjithashtu edhe raportet të Zyrës Rregullative të Ujit dhe Mbeturinave, të Zyrës Rregullative të Energjisë, të ART-së ai i fundit i ERT-së është miratuar në Kuvend diku në fund të ngushtit në fillim të shtatorit. Dhe ne nuk kemi mund ta përfundojmë ta finalizojmë raportin përderisa nuk kanë qenë këto raporte të finalizuara, përndryshe ne e kemi përfundua në fund të tetorit më 12 nëntor është t'u e shqyrtua dhe miratuar në Komisionin ... për ndërmarrje publike është procedua në Qeveri dhe më 8 dhjetor është miratuar në Qeveri. Raporti është përgatitur dhe Njësia në bazë të përgjegjësisë që e ka të monitoroj dhe të raportoj për performancën në mënyrë individuale dhe

kolektive duke u bazuar në performancën operative, rezultatet e arritura efikasiteti, kualiteti shërbimeve. Performancën financiare ...arritur efikasiteti i shpenzimeve profitabilitetit dhe komponenta e tretë që ka të bëjë qeverisje koperative në monitorimin e punës së bordeve, llogari dhënie planifikimi. Në fund janë të dhëna edhe disa rekomandime.

Dua të theksoj se nga raporti shihet se raporti është i përbërë prej tri pjesëve, pjesa e parë paraqet pikëpamjen e funksionimit të qeverisjes koprorative dhe funksionimin e njësisë për politika dhe monitorim gjatë vitit 2011. Pjesa e dytë ka të bëjë me performancën sipas sektorëve, subvencionimin e ndërmarrjeve publike, performancën financiare në përgjithësi. Dhe pjesa e tretë përmbledhja rezultatet dhe situatat në ndërmarrjet individuale dhe në të cilën paraqitet vizioni, misioni, objektivat, projektet e të tjera. Ky raport i përmbledh këto rezultatet por çështjet teknike apo nuk merret me teknike sepse këtu janë më shumë çështje të ndërmarrjeve publike individuale por informata më të hollësishme mund të merren edhe në raportin vjetor, ndërmarrjet publike në të cilat janë në UEB faqe.

Nga raporti shihet një krahasim i vitit paraprak ka progres në performancën financiare dhe dua ta them se performanca financiare është e bazuar në raportin e auditorit të jashtë. Dua ta ngriti një çështje për shkak se raportet e auditorit të jashtëm i kanë dy kolona vitin paraprak dhe viti aktual e që shpesh herë viti paraprak i raportit të fundit nuk përputhet me të dhënat e raportit paraprak po të auditorit të jashtëm, mund të jetë edhe i njëjti auditor. Dhe këto të dhëna janë bazuar në raportin e auditorit në vitin 2011, dhe mund të jenë të dhënat e vitit 2010 nga se vetë auditori ka ardhur në vitin 2011, ka vërejt ndryshime, ai ka paraparë të arsyeshme. Nga raporti shihet se një fitim i përgjithshëm vjetor për 11.8..... individualisht nëse shihet ... në krahasim me vitin paraprak kemi një progres sepse dy kompanitë i kanë arritur ndjeshëm fitimet, dy të tjera kanë arritur .. kompanitë e tyre në fitim financiar dhe shtatë nga ato kanë arritur t'i zvogëlojnë humbjet nga viti paraprak. Një performancë edhe më e mirë do të ishte e mirëseardhur edhe për kompaninë e Aeroportit Ndërkombëtarë "Adem Jashari" dhe kosti i "Ibër Lepencit", mirëpo kjo nuk ka mund të bëhet për arsye objektive pasi që krahasimi i të dhënave të vitit 2010 dhe 2011 në Aeroport.... sepse siç e dini tash pjesa e aeroportit ka mbet vetëm kontrolli ajrorë dhe natyrisht nuk ka të

Gjithashtu kosti ka disa probleme kontestuese në realizimin e të hyrave me KEK-un, ka marrë përgjigje pozitive nga Zyra Rregullative por lënda është në Gjykatë Supreme dhe nuk ka mund të dhe sa i përket ... ka mujtë të krijoj nga gjenerimi i energjisë për shkak të vitit 2011 nuk kanë qenë kushtet shumë të favorshme

Sa i përket performancës operative sipas sektorëve, vëreni te sektori i energjisë ka një progres ngase është prodhuar më shumë se në vitin paraprak për 3.2%, është gjenerua energji më shumë për 2.6%, është inkasua më shumë nga faturimi për 2.48% do të thotë inkasimi ka qenë në vitin 2010 88.6 e në vitin 2011 është 91.8%. dhe gjithashtu ka edhe zvogëlim të humbjeve komerciale dhe teknike të hyrat bashkë për 3.07. Këto janë të dhënat e raportit të Zyrës Rregullative.

E gjithashtu edhe në kost kemi një për operim jem duke fol, kemi reduktua ... për 62% dhe sa është rritë kapaciteti transumatorëve nga 1500 megavat atëherë në 1800 megavat amper. Sektori i telekomunikimit qëndron pak më ligisht, domethënë nuk jemi shumë, tregu i përditshëm i telekomunikimit në Kosovë e ka vlerën 250 milionë euro por pjesa më e madhe e cila për 80% e përfshinë telefonja mobile për Kosovë po flas, pjesa tjetër mbulohet nga telefonja fikse dhe interneti. Në Kosovë PTK-ja me të hyra e mbulon 70% të telefonisë mobile, 95% të telefonisë fikse nga të hyrat prej këtij sektori dhe 25% të internetit.

Nga tabela vërehet se ka progres vetëm te mbulshmëria e tregut nga telefonja fikse. Mirëpo edhe aty kemi një zvogëlim të numrit të konsumatorëve. Ndërsa te indikatorët tjerë te Vala dhe te

interneti ka një rrënjë të numrit të konsumatorëve. Kjo rrënjë shpjegohet si pasojë e një konkurrence nga operatorët tjerë por zvogëlimi i numrit të konsumatorëve nga përgjegjësit e Valës shpjegohet shpesh si pasojë e një procesi të reregjistrimit siç e dini se është bërë regjistrimi i konsumatorëve të rinj dhe pastrimit të regjistrimit të numrave pasivë.

Te sektori i ujit. Tek performanca operative vërejmë se kemi një rritje, domethënë numri i popullatës që është shërbyer në Kosovë është një milionë e 375 mijë apo rreth 70% janë popullata të cekura ... shërbimin e ujësjellësit. Përderisa vetëm 50% marrin shërbime Nga të dhënat në tabelë vërehen se sektori i ujit ka një progres të prodhimit të ujit për 4.5% në krahasim me vitin paraprak, është rritë inkasimi nga faturimi për 3%, ka qenë 65 u bënë 68 si sukses është rritur numri i konsumatorëve për 15 mijë e 406 konsumatorë. Mirëpo do të punohet akoma shumë për të bërë një progres më të madh pasi që viti 2011 e kishim një indikator jo të kënaqshëm siç ishte humbja e ujit e cila ka qenë në rritje për 1% që do të thotë për të kundërtën zvogëlim i faturimit. Lidhur me hapat që janë ndërmarrë dhe që po ndërmarrin për zvogëlimin e kësaj dukurie dhe humbjes së ujit, është punuar ngushtë me USAID-in edhe me një projekt që qeverisë të Luksenburkut dhe është punuar një strategji për ... e ujit. Por duhet ta pranojmë që ky sektor preokupohet me probleme ndoshta edhe çështje objektive nga se diku afër 19 mijë lëndë nga sektori i ujit gjemi nëpër gjykata të paralelizuar për mos inkasimin e borxhit.

Dhe borxhi i qytetarëve në këtë sektor është afër 80 milionë. Ndërsa fatkeqësisht nuk po mundemi të mbulohejmë nga buxheti i Kosovës në raste sociale sikur që zbulohen për energji dhe nga pas lufta janë inkasimet të pa faturuara për raste sociale afër 15 milionë, ... sigurisht do të rritej aftësia për investime edhe në rrjet për reduktimin e ujit. Kjo humbje, kjo humbje e ujit është edhe komerciale edhe teknike, komerciale ngase shpesh kemi keqpërdorim të ujit. Ndërsa kjo teknikë është për shkak të rrjetit të vjetruar. Fatmirësisht kemi donatorë investitorë të mirë për këtë sektor të cilët vazhdimisht investojnë në rrjetë e kam fjalën, përndryshe ka edhe projekte të reja të cilat janë në fazën e zhvillimit siç është projekti i fabrikës së ujit në Shkabaj i cili do të financohet nga Qeveria Gjermane, Qeveria e Kosovës, komuna e Prishtinës dhe Komisioni Evropian.

Gjithashtu ndërtimi i ... të zeza në Prizren i cili do të financohet nga Qeveria Zvicerane që i jep Kosovës dhe komuna e Prizrenit me një vlerë 22 milionë, Qeveria Zvicerane është duke e financuar në regjionin e Ferizajit dhe të Gjilanit me projekte të caktuar por edhe në zonat rurale. Ndërsa Komisioni Evropian në kohë të fundit ka kontraktuar një kontraktor për shqyrtimin gjegjësisht punimin e raportit të vizibilitetit për impiant të ujërave të zeza.

Për pjesën tjetër përndryshe për Gjakovë, për Pejë e Prizren e ka krye Qeveria Gjermane dhe tani pas aprovimit të projektit për Prizren shumë afër është që Qeveria Gjermane së bashku me Zvicerane të investojnë në Gjakovë dhe sigurisht do të investojnë edhe në Pejë. Tani më kjo ka standard ... që ujërat e zeza të trajtohen e të mos derdhen nëpër lumej, Aktualisht kemi një impiant në nivelin pak më të madh i cili është në funksion në Skenderaj i cili është lëshuar prej Komisionit Evropian. Janë lëshuar në funksion edhe dy impiant të vogël njëri në një fshat të Fushë Kosovës i financuar nga Qeveria Çeke dhe një në komunën e Gjakovës së Skivjan. Të them të drejtën këta është standard i mjedisit përndryshe është një barë bukur e madhe për kompanitë e ujësjellësve sepse këta impiant kanë kosto bukur të madhe. Ndërsa të hyrat nga këta impiant nuk janë këtu çfarë duhet të jenë. A te impianti i ujërave të zeza në Skenderaj koston kanë hyrë në tarifa dhe janë rritë tarifat në regjionin e Mitrovicës për 0.4 centë. Ndërsa për Prizren dihet ajo kur të lëshohet por do të ketë ndikim në rritjen e tarifave. Por derisa të hynë tarifa sigurisht Qeveria do t'i mbulon ato kosta se janë kosto të cilat nuk mundet me i përballua. Konkretisht ujësjellësi i Mitrovicë ballafaqohet edhe me distribujimin e ujit në veri. Uji i cili 39% nga prodhimi shkon në veri dhe ai ujë ka kosto sepse blehet fillimisht prej Ibër Lepencit trajtohet me kimikate dhe sulfatet dhe te ura e Ibër është një orë e cila e matë shpenzimin e ujit që shkon në veri. Ne si Qeveri mundohemi të mbulojmë sasinë e ujit me

çmimin me shumicë që e cakton Zyra Rregullative por e mbulon vetëm pjesën mesatare të ujit që nuk humb, mesataren që e ka caktua në fakt shpresojmë që këtë vit do ta ndihmon ndoshta edhe Zyra administrative për veri sepse kjo kompani ka bukur probleme, gjendet edhe me investime janë investime të Komisionit Evropian për ndërtimin e Fabrikës së re të ujit në Mitrovicë dhe nën investimin e Qeverisë për ndërtimin e Fabrikës së ujit në Vushtri.

Sektorin e mbeturinave e kemi, në sektorin e mbeturinave të ndërmarrjet publike qendrore bjenë vetëm kompania për menaxhimin e deponisë. Të them të drejtën, vazhdimisht kemi probleme me këtë sektor nga fakti se përqindja e inkasimit të kompanive regjionale të mbeturinave që e grumbullojnë mbeturinat dhe janë pronësi e komunave është shumë e vogël dhe ata nuk kanë mundësi që ta paguajnë tarifën që e kanë caktua Zyra Rregullative për deponimin e mbeturinave. Kështu që borxhi i kompanive regjionale ndaj deponimeve është 2.5 milionë. Shpeshherë keni pa nëpër shtyp ballafaqohem me presione sepse kompania që i menaxhon depozitë nuk është mirë por me i trajtua ato mbeturina dhe ato mbeturina shpeshherë vijnë deri te dera për shkak se kompania nuk ka mjete dhe nuk realizon mjete nga kompanitë regjionale. Tani më kohëve të fundit Komisioni ministrorë për ndërmarrjet publike e ka shqyrtuar këtë çështje dhe i ka sugjeruar këto çështje, i ka dërgua shkresë Komitetit ndërministrorë për partneritet publiko privat gjegjësisht kryesuesi i saj ministri të financave që ta shpejton këtë procedurë t'i shqyrton mundësitë e opsionit të futet kapitali privat në mënyrë që të investohet në këtë kompani. Përndryshe është shumë e vështirë mirëmbajtja.

Performanca e ndërmarrjeve publike gjegjësisht shërbimet publike mund të jenë shumë më të mira, askush prej neve nuk jemi shumë të stërkënaqur, progresi ka mund të jetë shumë më i madh. Megjithatë duhet të pajtohemi se asetet e këtyre kompanive për 10 vjet kanë qenë të keqtrajtuar nga regjimi i kaluar dhe tani e kemi bukur vështirë dhe problemin më të madh e kemi të ngritja ndoshta ngritja dhe pamundësia e qytetarëve me pagua dhe ndoshta të një pjesë ngritja e vetëdijes për me pagua obligimin shtetërorë si dhe mosefikasiteti Përdërisa kompanitë në bazë të standardeve ndërkombëtare kontabiliteti nuk u lejohet një borxh me cilësua si borxh i keq nëse nuk i merr hapat e caktuara që janë të paraparë me ligj edhe një ndër hapat është edhe procedimi i lëndës në gjykatë.

Shpeshherë lëndët e cilat procedohen në gjykatë duhet të paguhet taksa dhe taksat janë kosto më të mëdha se sa të hyrat që do t'i marrin në konto. 19 mijë lëndë të cilat presin e kanë sjell sidomos sektorin e ujit një gjendje shumë të keqe. Për sektorin e ngrohjes është sektor i cili bie në domenin apo pronësinë e ndërmarrjeve publike lokale por në bazë të ligjeve buxhetore, ligjit vjetor buxhetore përmes, ... mbahet edhe mbështetja financiare e ndërmarrjeve publike lokale të kompanive regjionale të mbeturinave e kapitale dhe të ngrohësve me subvencione. Vetëm gjatë vitit 2011, 4 milionë e 400 euro janë dhënë subvencione për blerjen e mazutit. Lidhur me subvencionet, e keni në tabelë subvencionet përkrahje financiare edhe në bashkëpunim me fondin monetarë është dakordua që të zvogëlohet të reduktohen subvencionet. Këtu kemi të dhënat vetëm për 2010-2011 por mund të ju them vetëm në vitin 2009 subvencionet kanë qenë 63 milionë vetëm për importin e energjisë. Ndërsa në vitin 2013 Qeveria do të financon import të energjisë vetëm 13 milionë. Nga 2010-2011 shihet që në përgjithësi përkrahja financiare ka ra nga 60 milionë në 47 milionë apo 26.5% por ky përkrahje për investime kapitale është një përkrahje e cila shteti investon në asetet e veta të cilat do të jenë ... Neve na brengos edhe më shumë subvencionet për kosto operative, subvencionet me të cilat Qeveria ka obligim të ju sigurojmë qytetarëve shërbime më të mira kualitative.

KRYETARI: Një ndërhyrje zoti Ramadan, nëse keni mirëkuptim. Do të ... pakë në pjesën e parë në mënyrë që deputetët të kenë mundësi me të pyet çka donë. Rrumbullaksoje për zgjedhjen e parë.

RAMADAN SEJDIU: Okej. Lidhur me dividendën, është pjesë e cila paguhet ... Siç e dini deri tani është marrë vetëm nga Posta dhe Aeroporti në vitin e kaluar janë marrë në vitin 2011, 55 milionë nga të cilët 50 milionë nga posta dhe 5 milionë nga aeroporti e cila pagesë është bërë në vitin 2011 por në fakt deklarimi është apo vendimi i bordit ka qenë i vitit 2010. Kisha edhe një pasqyrë të të dhënave të punëtorëve. Vëreni edhe ndoshta përfaqësoheni pse, ka ra numri i punëtorëve, në fakt nuk ka ra numri i punëtorëve, numri i punëtorëve është rritë për 158. Por në tabelën e 2010 ka hy numri i punëtorëve të aeroportit i cili për 660 punëtorëve është ... dhe nga kjo kur i heqim, kemi pranuar që po heqim 662 punëtorë del se në vitin 2011 kemi rritje të punëtorëve prej 158 punëtorë dhe atë për projekte të reja për shembull kemi në Skenderaj i cili ka rritë numrin, kemi një ujësjellës, Ujësjellësi i Prizrenit e ka në autorim Mamushën ... kemi ujësjellësin e Gjilanit ka marrë shumë fshatra nënoperim të cilat janë ... nga Qeveria Zvicerane. Kemi ndarje të hekurudhat të cilat në mënyrë që të forcohen shërbimet profesionale ka 20 do të thotë e kusurë. Punësimi sipas strukturës del se, nga aspekti gjinorë 88% ... mendoj janë meshkuj dhe 12% femra. Nga aspekti profesional kemi që 14% të numrit të punësuarve janë me përgatitje universitare, me përgatitje të lartë shkollore 3.7, me përgatitje të mesme 62%, me përgatitje të ulët shkollore apo shkolle fillore 23. këto janë të dhe janë me ... në punë fizike ... e të tjera.

Kur jemi te auditimi i jashtëm, pas përfundimi të çdo viti në ndërmarrje nënshtrohet auditimit të jashtëm pra auditori i jashtëm i pavarur apo nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm dhe e vëremi se raportet duhet me qenë lidhur me përputhshmërinë dhe ... e pasqyrave financiare në proceset e Kosovës ... dhe standardet e kontabilitetit del se nga aplikimi i këtyre kompanive 10 nga këtu kanë marrë opinionit të pakualifikuar si opinionit më lartë. E një nga këtu ka marrë opinion të kualifikuar, 6 nga këtu kanë marrë opinion të kualifikuar me theksim të çështjes dhe në krahasim në vitin paraprak është një progres sepse në vitin paraprak kemi pasur një sektor ...dhe kemi pas një raport të auditorit me mohim të opinionit ka qenë prerë ujësjellësi i Mitrovicës. Ka ndodhur edhe një proces tjetër të ndërmarrjet publike si është ristrukturimi. Në përputhje me Ligjin për hekurudha dhe me qëllim të futjes së përshtatjes së ekonomisë së tregut dhe futjes së kapitalit privat është ndarë hekurudha e Kosovës me operim dhe në infrastrukturë.

Gjithashtu Aeroporti Ndërkombëtarë siç e dini ju informova më herët. Korporata Energjetike e Kosovës, distribucioni dhe furnizimi i cili veç është kontraktua kalon në operim normal. Posta dhe telekomunikacioni gjithashtu me qëllim të vijimit të procesit të privatizimit është nda posta me pronësi shtetërore dhe ka mbet Vala, telekomi dhe interneti si ... e cila 75 aksioni do t'i nënshtrohet.

Isha ndal pak edhe te monitorimi i punës të bordeve .. përgjegjësitë e kësaj njësie. Njësia është formuar në përputhje me nenin 37 të Ligjit për ndërmarrjet publike. Deri në fund të vitit 2012 diku në muajin e nëntë ka operua vetëm me 5 punëtorë, tani e kemi numrin e aprovuar me 7 të punësuar, 6 analistë dhe udhëheqësi. Sigurisht se kemi nevojë për kapacitete më të mira, është një projekt i Zyrës Zvicerane i cili do ta mbështesë sivjet trajnimin e bordeve të drejtorëve të ... të njësive edhe do të na ndihmon. Shpresojmë që kjo do të implimenton.

Prej 16 ndërmarrjeve publike që janë monitorua mund të ju njoftojmë se janë mbajtur 185 mbledhje të bordit të drejtorëve, 139 mbledhje të komisioneve të auditimit. 73 mbledhje të komiteteve të tjera. Njësia në emër të aksionarëve ... vëzhgues ka marrë pjesë në 37 mbledhje të bordeve dhe me 16 mbledhje të përgjithshme vjetore ... të paraparë me Ligjin për Njësia nuk e ka të drejtën me anulua vendime por aty ku vërehen që vendimet nuk janë me procedura dhe me ligjet e ka të drejtën me i rishikua vendimet. Njësia gjatë vitit 2010 ka kthyer 3 vendime në rishikim nga bordi i drejtorëve.

Shpresojmë që raportimi i ardhshëm do të jetë jo shpresojmë por do të jetë shumë më përpara ngase kjo çështje është rregullua me ndryshimin e ligjit për ndërmarrje publike. Pasi që ndërmarrjet publike e kanë të obliguar tani më raporti për pasqyrat financiare të vitit 2012 të audituar dhe të miratuar nga bordi deri më 30 maj, kështu që ne nuk do ta presim gushti qysh e kemi pritur sivjet por tani vetëm do të presim zyrat rregullative dhe do ta prezantojmë më herët. Është bërë prokurorimi në infrastrukturën ligjore, është bërë ndryshimi i ligjit i cili ka prekur disa çështje, komunikimi me komuna. Dje është miratuar një aktligjor i cili e rregullon pjesëmarrjen e komunave në bordet e ujësjellësve dhe kriteret e formimit të ndërmarrjeve publike lokale. Tani më janë plotësuar te kushtet që të procedojmë me konkursin për përzgjedhjen e bordeve të reja, siç e keni bërë të reja afatin e rregullt e kam pasur deri në dhjetor të vitit 2011 me vendim të aksionarit gjegjësisht Qeverisë të Republikës së Kosovës. Duhet me pas parasysh se ligji ka qenë në amendamentim, nga kërkesa e komunave që të rregullohet çështja e ujësjellsave, pjesëmarrja e tyre ... tanimë mendoj që janë pjekë kushtet që konkursi të përcedohet dhe sigurisht do ta kemi edhe ne si njësi shumë më lehtë.

Dua të ju bëj me dije edhe një gjë. Qeverisja kooperative është një branshë e re në Kosovë. Kjo ka filluar, në fakt, nga 2006 nga AKM-ja, por stafi lokal ka shumë pak përvojë. Ky ka filluar nga 2009-shi. Garnitura e parë e Bordit të drejtorëve, sigurisht që ... janë përcaktuar edhe në vlerësimin, në raportin e vlerësimit të efektshmërisë së punës së tyre, të cilën neve e përcjellim përmes procesverbaleve, vendimeve, prezencës. Dhe, shpresojmë që bordet e reja, nga përvoja që kemi marrë, nga përforsimet, gjegjësisht përforsimet e infrastrukturës ligjore, do të jenë më të mira. Ministria kohëve të fundit ka marrë një iniciativë për ta ngritur çështjen e nivelit të monitorimit të mbikëqyrjes. Siç e dini më herët është miratuar Kodi i etikës dhe qeverisjes kooperative dhe tanimë jemi në fazën e konsultimeve me akterët tjerë, me ministrinë dhe ndërmarrjet publike dhe i kemi përgatitë, janë në përgatitje draft-rregulloret, që sipas ligjit mund t'i bëjmë, akte nënligjore modele, që quhen mbi udhëtime zyrtare, sepse kemi pas një laramani të tarifave e kushteve, nga ndërmarrja në ndërmarrje dhe një model draft-rregullore për shfrytëzimin e veturave zyrtare, ngase kemi shpeshherë keqpërdorim të veturave, të cilat shpeshherë ndoshta dikush nga ne i kemi parë nëpër vikende nëpër... pa logo, pa... dhe tash mendojmë që ta rregullojmë këtë çështje.

Dhe, gjithashtu në mbledhjen e fundit të Komisionit të Ministrave, Komisioni i Ministrave ka marrë dy vendime. Vendimi i parë ka të bëjë me anulimin e një vendimi të Bordit për dhënien e bonuseve, sepse ndryshimi i ligjit e përcakton qartë, se bonuset mund të jepen vetëm nëse ka arsyeshmëri, gjegjësisht ka rezultate pozitive vetëm pas auditimit të pasqyrave financiare dhe mendimi tjetër ka të bëjë me tri pika tjera. Një është, se asnjë ndërmarrje publike nuk mund të merr bonuse, në rast se merr subvencione nga Qeveria. Kur them subvencione, nuk mendoj në mbështetje për projekte kapitale, se ato janë asete, por subvencione për ndihmesë të shpenzimeve operative. Dhe, asnjë ndërmarrje nuk mund të merr bonuse edhe nëse ka rezultate pozitive, përderisa nuk auditohet pasqyra financiare nuk... edhe aksionari dhe mendimi i tretë ka të bëjë me një analizë të detajuar të pagave të zyrtarëve të lartë të ndërmarrjeve dhe të Bordit të drejtorëve, analizë të cilën jemi duke e punuar dhe do të finalizohet me një draft-rregullore, që ta rregullojmë edhe këtë çështje, sepse siç e dini, keni parë shpeshherë janë edhe në ueb-faqe të dhënat, se kemi drejtorë të ndërmarrjeve, të cilët ndoshta kanë dyfishin e pagës të kryeministrit apo të presidentes. Dhe, edhe ajo është para publike, dëshirojmë ta bëjmë një rend, por sigurisht se na duhet mbështetja, kapacitetet, përvoja, trajnimet. Shpresojmë që të...

Performanca individual, nuk isha lëshuar, zoti kryesues, zoti deputet, mund ta trajtojmë çdonjërin prej tyre, por ne iu kemi drejtuar një shkresë të gjithë bordeve, që ta shqyrtojnë me... kjo është shqyrtuar edhe në mbledhjet e përgjithshme vjetore, rezultatet e vitit 2011 dhe do të përcillet. Lidhur me, shpeshherë përmenden bonuset e bordeve, sigurisht kemi pas çështjen edhe kërkesën nga Komisioni për Monitorimin e Financave Publike. Neve ligji bazik i ka pas disa

mangësi. Mangësi që kanë qenë në ligjin bazik, kanë qenë sepse bordet honorari për borde përcaktohet me një vendim të Qeverisë, i cili është përcaktuar, ndërsa bonusi për efektshmëri mund të merret në bazë të një deklarate për politikën e kompensimeve, që e miraton Komisioni i Auditimit, i cili nuk mund ta tejkalojë totalin e pagave vjetore, do të thotë me ndryshimin e ligjit është rregulluar kjo çështje.

Nuk mund ta merr asnjë anëtar i bordit bonos, për pa u audituar pasqyrat financiare dhe me u vërtetua dhe nuk mund ta merr 100%, por maksimumi është nëse janë tejkalu ... 50%. Ne i kemi pas disa, me thënë, njoftime rreth këtyre çështjeve. Aty ku kemi pas njoftime, ne i kemi marrë disa hapa. Kemi drejtuar letër Komisionit të Auditimeve që t'i angazhojnë raportet, t'i angazhojnë kompensimet e bordeve t'i auditojnë kompensimet e bordeve të drejtorëve dhe bonuset, të tri kompanitë më të mëdha, nga dy nga kompanitë kemi marrë raportin nga një po presim ta marrim raportin.

Kjo është në pika të shkurtëra, në fund të raportit janë edhe disa rekomandime, të cilat sigurisht i keni. Rekomandimet janë dhënë nga fakti, që mendojmë që e shtojnë ...

KRYTARI: E kishim përmbyllë këtë pjesë. Faleminderit, zoti Ramadan, për gatishmërinë me pas prezantim më të detajuar. Kolegë deputetë, ju e patë dhe e dëgjuat prezantimin e përfaqësuesit të Ministrisë të Zhvillimit Ekonomik. Dëshiroj të ju jap fjalën një herë për pyetje e pastaj edhe për komente.

Unë kisha dashur t'i theksoj vetëm shkurt, që ka pas në disa prej takimeve të komisionit, në disa raste të mbledhjeve të komisionit gjatë vitit që shkoi, që i kemi trajtuar ndërmarrjet, çështjet të ndryshme që kanë të bëjnë me ndërmarrjet publike. Ka qenë disa herë edhe një gatishmëri e përbashkët, që me pas përveçse asaj punës së zakonshme që e bëjmë në ligje, me pas edhe një aktivitet më të shtuar në monitorimin e zbatimit të ligjit. Jam i sigurt, që sivjet në agjendën tonë do të bëjmë diçka më shumë në këtë drejtim. Kemi ngritur disa herë shqetësime të ndryshme, që kanë të bëjnë me funksionimin e segmenteve të caktuara në ndërmarrjet publike dhe vetë ndërmarrjeve publike, menaxhimit, funksionimit të bordit, shpenzimit të parasë publike dhe çështje tjera, të cilat disa herë kanë qenë edhe publike në shtypin dhe në mediat tona.

Sidoqoftë, unë kisha dashur që deputetët me e pas fjalën, me pas edhe ndonjë pyetje, me pas edhe ndonjë koment ose një qëndrim të tyre rreth çështjeve të caktuara. E falënderoj po ashtu edhe GAP-in, që ka bërë edhe komente lidhur me këtë raport. Ne kemi pas po ashtu, edhe një raport vitin e kaluar, më duket, për funksionimin e bordeve të ndërmarrjeve publike. Ka qenë shumë ndihmues. Edhe i ftoj po ashtu, organizatat tjera, INDEP-i, që është me ne dhe të tjerët, që kanë interesim me na ndihmua në procesin e monitorimit të funksionimit të ndërmarrjeve publike. Ju e keni po ashtu këtë, komentet e GAP-it, që janë jashtëzakonisht të mira dhe ndihmuese në sqarimin e këtij raporti.

Ajo çka unë, fillimisht po mendoj, që ishte dashur neve me na interesu edhe më shumë është, nëse në përfundim të këtij raporti, ose të këtyre raporteve, do të ketë ndonjë ide që kanë për qëllim edhe ndryshimin, inicimin e ndryshimit të ligjit, ose përmirësimin e ligjit, ose legjislacionit. Sidoqoftë, ideja jonë është që përveç një raportimi të tillë, që bëhet një herë në vit, me pas si deputetë mundësinë, që edhe në ndërkohë me pas qasje ose mundësi në monitorimin e zbatimit të ligjit.

Faleminderit shumë dhe fjalën e keni ju kolegë deputetë. Zonja Selmani fillimisht, pastaj zonja Teutë Sahatqija.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, kryetar!

Përsëritet për deputetët dhe për raportuesin, i cili vjen nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, në lidhje me performancën e ndërmarrjeve publike, të sjellë një raport të tillë. Mirëpo, duhet thënë shumë sinjerisht, ti e ke për obligim me e prurë këtë raport këtu, mirëpo raporti si raport është tmerr.

Pikë së pari du me u nisë prej secilës ndërmarrje pikë e për pe, kështu me të thënë atë anën tjetër tënden, se ti fole pak më gjatë. Ne e kemi raportin dhe e kemi të lexuar, fatbardhësisht. Unë po them, personalisht duhesh t'i marrësh vërejtjet në mënyrën profesionale. Në rast se e shohim çështjen e qeverisjes kooperative, që ju e potencuat në Ligjin për ndërmarrje publike, që është shumë i ri në Kosovë dhe çështjen e funksionimit të këtyre ndërmarrjeve publike, mund të them se definitivisht, nuk ka performancë të mirë absolutisht nga viti i kaluar, të këtyre ndërmarrjeve publike, duke u nisë më së pari nga KEK-u. Në rast se e shihni, pasqyrat të cilat i keni sjellë në këtë raport, më vjen shumë keq ta them, ka njerëz të cilët në vitin e kaluar nuk i kanë udhëhequr këto ndërmarrje publike, iu figurojnë emrat aty. E dyta, më e keqja, është se në rast se mendon KEK-u si ndërmarrje publike, që sektorin e energjisë ta balancojë me raportin e Zyrës së Rregullatorit të vitit 2011, është një ndërmarrje e cila merr subvencione nga Qeveria e Kosovës, nga Buxheti i Kosovës. Dhe, çështja e humbjeve komerciale dhe e humbjeve teknike... ata e kanë pas një limit si performancë me e arritë 3%.

Unë prapëseprapë, nuk jam kah të drejtohem ty. Ky është raport të cilin je i obliguar me e sjellë në Kuvend të Kosovës, në bazë të Ligjit të ndërmarrjeve publike, si njësi për monitorim. Humbjet në KEK janë zvogëluar vetëm 1.2% dhe 4 milionë janë humbje. 4 milion, në rast se shohim në të holla, 4 milionë janë humbje. Performanca e një menaxheri të një ndërmarrjeve publike llogaritet në bazë të të arriturave të asaj ndërmarrjeve publike dhe ne, në rast se e kemi bërë privatizimin e Distribucionit dhe Furnizimit, cilido investitor i huaji, që vjen në Kosovë, prapëseprapë edhe ai ka me qenë i dështuar baraz me neve, për arsye se ne s'kemi mbërri kurgjë me e rritë performancën e KEK-ut. Ka këtu shumë... këtu e ka potencuar ai çështjen si ka shkuar çështja e prodhimit të qymyrit. Esenca është te humbjet. Humbjet, performanca në humbje. Zoti Ramadan, me gjithë respektin zoti Ramadan, unë po u drejtohem për raportin, jo ty personalisht, por raportit. Këtu janë të dhënat, të cilat janë dhënë veç sy e faqe, mirëpo ne jemi deputetë dhe Komisioni për Zhvillim Ekonomik, ka të bëjë me çështjen e politikave të zhvillimit ekonomik të ndërmarrjeve publike.

Te posta, e potencuat edhe vetë ju, llogaritni në pasqyrën e performancës së Postës, akoma qëndron emri i drejtorit të kaluar. E njëjta situatë qëndron edhe te KOST-i, ku zonja Merita Kostari është anëtare e Bordit të Zyrës së Rregullatorit, emrin e ka këtu. Është turp, ajo ndërmarrje apo ajo ministri, e cila e sjellë një raport të tillë te deputetët e Kuvendit të Kosovës, kur deputetët e Kuvendit të Kosovës janë ata të cilët i miratojnë edhe bordet e agjencioneve të pavarura në këtë Kuvend të Kosovës dhe në rast se ata duan të shesin gogla për dushk, këtë raport unë e them shumë sinjerisht, është mirë me ua dhënë dhe me u thënë: merreni, kontrollojeni mirë çka keni shkru në të, nuk dua unë raport, të cilin e miratojmë ne të agjencioneve të pavarura, qysh është Zyra e Rregullatorit, ART-ja, Aviacioni Civil. Dhe tash e njëjta performancë të shkruhet në raportin e ndërmarrjeve publike. Ato janë të lidhura njëra me tjetrën, se zyra e rregullatorit është një zyrë, e cila e monitoron çështjen e KEK-ut, mirëpo të shkruhet çka ka shkru Zyra e rregullatorit, të miratohet edhe njëherë për së dyti... më fal, më fal, ne i kemi dokumentet këtu. Ne punojmë me dokumente. Në rast se ata punojnë për ta rritur performancën e ndërmarrjeve publike, unë them nuk është kjo performancë e ndërmarrjeve publike, kjo është me dhënë para koti dhe mos me tregua rezultat. Veç në rast se ndalesh te rekomandimet në fund, dhe mjaft me keqardhje, se ti ke ardh me raport, ata s'kanë ardhur këtu, se ata është mirë me ardhë këtu dhe me ju tregu ku e kanë vendin.

Shih në rekomandime çka thuhet: “Trajnimi i stafit të ndërmarrjeve publike, për përmbushjen e kënaqësisë së konsumatorëve.” Cilave përmbushje të kënaqësisë së konsumatorëve!? Ata janë të obliguar, se konsumatorët janë njerëz të cilët i mbajnë këto ndërmarrje publike. Shumë sinqerisht, unë... më vjen rëndë që ta them, veç në rast se e lexon përmbledhjen e fundit dhe rekomandimet e fundit, nga faqja 90, 91, unë nuk e di çka lypin ata njerëz me ndejt në ato ndërmarrje publike, çka lypin? Është ... duhet me e merituar atë pagë, në rast se rrin në atë ndërmarrje publike. Dhe, ato borde, është një përplasje e madhe në mes bordeve dhe drejtorëve menaxhues të këtyre ndërmarrjeve publike. Ne e kemi pa, jeta.. çështjen e bonuseve, me shumë keqardhje, s’dua ta diskutoj çështjen e bonuseve as kurrëgjë. Këtu duhet të bëhet një ndërrim rrënjësor, prej atij më poshtë që është e deri te menaxheri kryesor dhe kryesisht edhe te bordet, dhe politikat e ekzekutivit të jenë strikt. A po dojnë me pas ndërmarrje publike profitabile dhe t’i plotësojë kërkesat e konsumatorëve, jo “t’i përmbushë kënaqësitë e konsumatorëve”. Cilat kënaqësi more? Këtu s’është punë familjeje, kënaqësi e pakënaqësi... ai është i obliguar me i përmbushë kërkesat e konsumatorëve, nëse don me pas përfitim, si kompani publike.

Unë po them edhe njëherë, po me vjen shumë rëndë prej teje, se ti s’duhesh të ballafaqohesh me këtë, ti e ke pru raportin, ti je njësia për monitorim në nivel të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, veç ky raport është mirë edhe njëherë me pa çka kanë bërë në këtë raport, se ne jemi deputetë. Nuk kemi ardhë këtu administratë, me i pa emrat kah i përsërisin, prej atij agjencioni të pavarur të qiten në ndërmarrje publike aty, siç është rasti edhe i Shyqyri Haxhës në Postë telekomin e Kosovës, emrat janë përsëritur krejt.. Më vjen shumë keq. Dikush aty është dashur t’iu thotë: merreni këtë raport, lexojeni mirë dhe shikoni çka keni bërë në të.

KRYETARI: Faleminderit shumë, zonja Selmani! Zonja Teuta Sahatqija e ka fjalën, pastaj deputetët dhe në fund ju japim prapë fjalën juve.

TEUTA SAHATQIJA: Faleminderit, kryetar!

Ne e morëm një arsyetim pse jemi duke diskutuar për raportin 2010 – 2011. në fakt 2011 në krahasim me 2010 dhe arsyetimi i ri ishte, për shkak të auditimit. Besoj, që shumica e të dhënave prandaj edhe na duken të vjetra, sepse jemi duke diskutuar për një raport të vjetruar, për një raport i cili do të duhej të ishte i 2012-ës e ne jemi duke folur për 2010-ën.

Prej raportit po e shoh, që fatkeqësisht, shumë pak ndërmarrje janë ato që kanë pas një performancë financiare pozitive apo një fitim. Është PTK-ja me 46 milionë, KEK-u 16 milionë, KOST-i 1.3, Aeroporti diku 396, as 400 mijë euro. Është interesant të krahasohet me 2010, ku Aeroporti ka pas fitim 6 milionë, ndërsa në 2011 është 400 mijë euro. Ndoshta edhe mund ta shpjegoni se përse është ky dallim prej 6 milionëve, as në gjysmë milioni brenda një viti. Gjithashtu, ngjashëm situata është edhe në KOST, ku 3.4 milinë në 2010-ën fitimi është 1.2 milionë.

Në fakt, PTK-ja dhe Aeroporti dhe këto të cilat në raport duken që kanë performancë pozitive, kjo s’ka të bëjë me ju, por janë pikërisht ato ndërmarrje, të cilat po privatizohen, ndërsa ato ndërmarrje që kanë raport negativ, ato po i mbajnë për vete, ndërsa ato me fitim po falen diku tjetër. Normalisht që me monitorim kjo nuk ka të bëjë, kjo ka të bëjë me politika. Në anën tjetër, vërejta që është dallimi te punëtorët, 662 punëtorë janë më pak në krahasim me 2010 – 2011 në Aeroport. Ju e shpjeguat, por kishte qenë mirë edhe një shpjegim i shkurtë, se pse është ky dallim kaq i madh, apo është vetëm pjesa e cila ka mbetur si ndërmarrje publike, prandaj edhe duket që është numri më i vogël në Aeroport.

Në anën tjetër, te Hekurudha, po them me siguri është për shkak se është shënimi i vjetruar, por shihet që për në 2010-ën, vazhdojnë deri më 31.12, ndërsa raporti i 2011-ës te hekurudhat është prej 1 janarit deri më 31 gusht, jo deri më 31.12. edhe këtu, pse nuk është raporti i përfunduar

deri në fund të vitit, por është vetëm deri në gusht. Prandaj edhe numrat të cilët krahasohen, me siguri janë numra që nuk mund të krahasohen, se ajo është për një gjysmë viti, ndërsa 2010 është komplet vitin. Dhe unë e kam vërejtë, kështu që ... e kqyra edhe njëherë vitin dhe thash jemi tu fol për raportet tjera.

Kisha pas dëshirë me e shpjegu këtë që KEK-u po duket që ka 16 milionë e gjysmë fitim, në anën tjetër, ka 4 milionë e gjysmë subvencione, për raste sociale dhe është dalluar, edhe ju e cekët edhe unë më herët e pata shënuar, 60 milionë në 2010-ën, në 60 mijë në fakt në 47 mijë në 2011-ën. Si është e mundur që në njërën anë ka subvencione, në anën tjetër del në fitim. Atë edhe ju e cekët, por është mirë të analizohet, qysh është e mundur që ajo të del në fitim, ndoshta jam e sigurt që edhe bonuset ndahen për fitim, ndërsa në anën tjetër me milionë merren subvencion e prej Qeverisë.

Edhe tjetra, unë nuk e vërejta ndonjë raport krahasues, në mes të gjinisë mashkullore dhe femërore. Ju kur e përmendët, e përmendët vetëm në një prej ndërmarrjeve, po kisha pas dëshirë qysh është, në qoftë se është 88% me 12%, atëherë me të vërtetë duhet me u marrë me këtë dhe me tentu me e rregullu edhe këtë çështje.

Unë i pata shënuar këto, por në ndërkohë mund të flasim edhe për gjëra tjera. Faleminderit!

KRYETARI: Visar.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!
Përhëndetje, zoti Sejdiu, zonja Kuka,

Unë, natyrisht në këtë fjalë timen, të cilën do të tentoj ta mbaj sa më të shkurtë, do të kem edhe komente edhe pyetje, të cilat rrjedhin drejtpërsëdrejti nga raporti.

Mendoj që kështu si një vlerësim i përgjithshëm është që, meqenëse ky është raport që vjen nga Qeveria, nga Ministria për Zhvillim Ekonomik, shihet që në njërën anë Qeveria nuk e ka fort të qartë, mendoj unë, ose nuk ka fort vullnet që me qenë më aktive në përmirësimin e punës së këtyre ndërmarrjeve publike, domethënë të gjitha ato mangësi në funksionimin e tyre disi kundrohen nga Qeveria, si një lloj spektatori më shumë se sa përgjegjës që është, domethënë si përmbajtës i 100%-të të aksioneve të këtyre ndërmarrjeve publike, pra që do të duhej ta kishte edhe këtë komponentën e ndërhyrjes në to, në mënyrë që ta përmirësojë punën e tyre. Pra, ne e dimë që realisht këto nuk lihen të veprojnë ashtu, siç do të duhej të vepronin, ndoshta ... të ndahen nga Qeveria, por formalisht e kemi njëlloj ndarje, e cila nuk i shërben përmirësimit të punës së këtyre ndërmarrjeve publike. Dhe, në anën tjetër, mendoj që raporti në shumë aspekte është i mangët, për shkak se konsideroj dhe është e qartë, që është raport i cili i përmbushë ndoshta, në mënyrë shumë të vrazhdë kështu, kriteret ligjore për raportim, po i mungon ky aspekt analitik. Pra, kemi një raport i cili përmes tabelave jep të dhëna qoftë të performancës operative financiare e kështu me rradhë të ndarmerrejeve dhe pastaj teksti që vjen nën tabela është shpjegim i të dhënave, që nuk ka nevojë. Domethënë, nëse thuhet për shembull, që të hyrat kanë qenë, ku ta di unë... 2 milionë, në 2011-ën 1 milionë në 2010, atëherë teksti përfundit s'ka nevojë të na tregojë që rritja është për 50%, se ne secili e dimë ngapak matematikën edhe po të mos e dishim, e kemi nga një digitron, ku do të mund të llogarisnim sa përqind është. Domethënë teksti shpjegues nën tabelë duhet të jetë arsye pse ka ardhur deri te kjo rritje ose rënie e të hyrave, e kështu me rradhë. Për shembull, i kemi këtu disa shpjegime, që për mendimin tim janë pak edhe vështirë me u besu, që dikush në ministri mundet me mendu kështu ose me e heq përgjegjësinë nga vetja. Për shembull, te faqja 24, pa hy te ndërmarrjet individualisht, po te sektori i telekomunikimit, kemi për shembull kësi fjalish. Te rënia, ka një rënie në numër të

konsumatorëve dhe një rënie të mbulueshmërisë së tregut. Pastaj fjalja tjetër është, kjo rënie mund të ketë ndodhur si pasojë e konkurrencës nga operatorët tjerë në treg.

Mund të ketë ndodhur, por ne të gjithë e dimë, që mund të ketë ndodhur, por duhet një analizë pse ka ndodhur, saktë të na tregojë pse ka ndodhur. Se qajo është raport se kjo “mund të ketë ndodhur”, mund të ketë ndodhur edhe për shkak që njerëzit s’po flasin me telefon, mund të ketë ndodhur për shumë arsye. Kemi edhe te sektori i energjisë, kur flitet kështu në përgjithësi. Pra, kemi poashtu shënime, që është rritur, ta zëmë prodhimi i thëngjillit, është rritur faturimi, inkasimi, janë reduktuar humbjet në transmision, janë arkëtuar humbje të njëjtë komerciale, por nuk ka ndonjë shpjegim që e tregon pse, qysh ka intervenuar ndërmarrja, cilat kanë qenë intervenimet e suksesshme, cilat jo, çka e ka nxitë këtë faktor, se rritje pozitive veçanërisht ne duhet t’i analizojmë pse, në mënyrë që të aplikojmë dhe t’i shumëzojmë në vitet e ardhshme, në mënyrë që të kemi pastaj rritje më të mirë të performancës. Por, duhet ta dimë arsyen pse po ka sukses ose mossukses në një ndërmarrje, në mënyrë që

I kam disa pyetje, kështu te ndërmarrjet publike, individualisht, për shembull në secilën tabelë, përveç më duket te PTK-ja, në secilën këtë tabelë hyrëse që e keni, ku është emri i kompanisë, po ... pronësia, kapitali aksionar, te kapitali aksionar e keni 25 mijë euro te secili. Te secila kompani, qoftë ... unë fillimisht i shikova vetëm ato të ujit, mendova që po flitet për të ujit, domethënë është shuma e njëjtë, meqenëse janë kompani të ngjashme, por pastaj e pash që te KEK-u është e njëjta, te Hekurudhat është e njëjta dhe nuk po e kuptoj ku, si është vlerësuar ky kapital aksionar. A është vetëm kështu shabllon i vendosur aty, apo vërtetë është bërë një analizë, që kemi ardhur në përfundim që edhe KEK-u e ka kapital aksionar 25 mijë euro, kapitalin fillestar edhe Ujësjellësi regional i Gjilanit. Këtë thjeshtë nuk mund ta kuptoj pse është ashtu. Pastaj, i kemi te ndërmarrjet publike, te të gjitha gati, thuhet përveç objektivat, domethënë se ... pastaj nuk kemi kurrfarë shpjegimi se përgjatë vitit deri në ç’masë janë plotësuar këto objektiva, se nuk po flasim për një vit të caktuar, për vitin 2012, për performanca për vitin 2012, kur natyrisht ndërmarrja ka vendosur disa objektiva të reja, dhe pastaj nuk kemi një raport të përmbushjes së këtyre objektivave. Deri në ç’masë, objektiva 1 është përmbushur 50%, e nuk ka mundur të përmbushet 100% për shkak të këtyre arsyeve. Pra, këtë unë do ta quaja raport.

Tjetra është që po ashtu, është edhe te projektet, thuhet që janë nisë projektet, pra divizioni ... po nuk tregohet a janë përfundu, kur janë përfundu, a do të përfundohen në vitin 2012, çka pritet domethënë, prej këtyre ndërmarrjeve. Është edhe kjo që e përmendi edhe zonja Sahatqija, pra e kemi te Hekurudhat në fund, pasqyrat financiare deri në 2011. pra, një prej arsyeve që e përmendët ju që pse është vonuar ky raport, ka qenë edhe auditimi, pasqyrat e audituara financiare. Ndërkohë, që për disa ndërmarrje, tri sosh, i kemi raportet e audituara financiare, për shkak se s’ka mundur të bëjnë auditim për gjashtëmujorin e ... Për sa i përket këtui, mendoj që ... se këtu u përmendën disa gjëra subvenciale, për shembull tash ... duhet ta ... se kjo pagesa që e bën Qeveria për rastet sociale, për pagesën e energjisë elektrike, ajo nuk është subvencion për KEK-un, por është subvencion për... domethënë, është pjesë e skemës sociale e jo subvencion për KEK-un dhe e dyta, natyrisht që importi i rrymës, tash nuk e di në çfarë mase ka qenë këto para që janë dhënë, janë dhënë për import të rrymës. As importi i rrymës nuk është subvencion për KEK-un. Këtë duhet ta kuptojmë, se pastaj po krijohen nganjëherë përshtypje, që ne e subvencionojmë KEK-un shumë. Importi i energjisë elektrike është blerje e energjisë elektrike. Është njëjtë si me thënë, që importimi i grurit është subvencion për bujqësinë, nuk është. Domethënë, është çka mundet me prodhu KEK-u prodhon, çka s’mund me prodhu ne importojmë. Ato, importon Qeveria, por kjo nuk është që ne po i ndihmojmë KEK-ut, po e përmbush, domethënë e përmirëson furnizimin me energji elektrike në Kosovë, në përgjithësi.

Tash, desha të dal pak te këto rekomandimet. Së pari te këto rekomandime, nuk po e kuptoj së pari, kush po i bën dhe kujt po ia bën. Domethënë, këto janë rekomandime, që dalin prej njësisë,

prej njësisë që... këto rekomandime a i drejtohen Kuvendit, a Qeverisë, a ndërmarrjeve, se nuk është fort e qartë, se tash me këtyrë kështu realisht, shumica prej këtyre rekomandimeve, jo të gjitha, por shumica e këtyre rekomandimeve duhet të plotësohen nga ndërmarrjet, por njëllëj përgjegjësie e ka Qeveria në plotësimin e tyre. Besoj që po flasim për të gjitha ndërmarrjet. Tash, a i bie kjo që Qeveria po i rekomandon Qeverisë, apo këto janë rekomandime, vetëm sa për të vënë në pah ato çështje që duhen diskutuar dhe për të cilat pastaj Kuvendi do të duhej të dilte me rekomandime të reja, që mund të bazohen në to, për Qeverinë, se është këtu njëllëj ... po më duket mua, njëfarë konflikti në atë se kush do të duhej t'i plotësonte këto dhe çështja tjetër që unë e kam te rekomandimet, është se janë jashtëzakonisht të përgjithësuara. Pra, rekomandime të përgjithësuara, të cilat në njëfarë mënyre janë rezultat i mungesës së qasjes analitike në raport. Pra, kur nuk kemi qasje analitike në raport, atëherë rekomandimet domosdo, do të jenë të përgjithësuara për shkak se konkretisht s'di çka me rekomandu. Pra, thuhet avancimi i mëtejshëm i qeverisjes kooperative. Kjo është... domethënë, s'ke nevojë me e thënë këtë hiç. Natyrisht, që përherë, për çdo vit pritet që të ketë avancim. Nuk mundet, veçanërisht jo në këtë gjendje, por kurrë nuk duhet të arrijmë në një moment të vetëkënaqësisë, kur themi që më nuk duam të përparojmë, pra të rekomandojmë që nuk ka nevojë më të avancojmë, se e kemi mbërri. Pastaj, trajtimi me prioritet nga gjykatat kompetente, kjo është në rregull, domethënë kjo po i drejtohet sistemit gjyqësor në njëfarë mënyre, që me i trajtua këto raste, për të cilat pajtohem plotësisht në këtë rekomandim.

Investime, edhe me tutje në rrjetin e vjetruar të ujësjellësve, të gjitha këto janë rekomandime, në njëfarë mënyre vetëm sa për të qenë, se jo që mendoj unë, që këto rekomandime e nxisin njëllëj ndryshimi të qasjeve dhe punës në këto ndërmarrje publike, për t'ua rritur apo përmirësuar atyre performancën. Kaq kam për tash.

.... Të ndryshimeve të qasjeve publike për t'i bërë ato për t'ia rritur apo përmirësuar atyre performacat. Kaq kemi për tash.

KRYETARI: Ju faleminderit, zoti Ymeri! Fjalën e ka zoti Deshishku.

HASHIM DESHISHKU: Ju faleminderit, kryetar!

Meqenëse ne, e tha edhe zoti Ramadani dhe zoti, zoti Sejdiu, thanë më herët se ky raport është i vitit 2011 dhe normal që jemi duke diskutuar për arsye se është një vonesë mjaft e madhe. Ne i kemi dy kompani të cilat tash janë privatizuar dhe tash nuk kemi edhe që e shqyrtojmë këtë raport, në krejt sektorin tjetër kemi të kompanisë, është privatizuar sikur distribucioni sikur Aeroporti. Ne do ata shqyrtojmë, por besoj se nuk ka me vlerë, I bëjmë disa vërejtje të cilat nuk do të kenë vlerë, unë megjithëse këta kolegët e mi i thanë disa të dhëna financiare, meqë janë dalë shumë shkurt te konsumi i ujit te i cili është humbje e madhe e tyre, do me thënë ta quaj humbje e madhe aty edhe faturimi që nuk po bëhet, nuk e di se deri kur do të zgjidhet ky problem i ujit dhe i rrymës të cilët po kanë humbje apo inkasomi i tyre dhe në raport nuk përmendet kush sa kanë obligime te KEK-u sektori privat dhe organizatë, duhet të ceket se sa obligime janë për atyre që i kanë obligime KEK-ut.

Nuk e di, unë nuk e kam pasur ndoshta, por nuk e kam pasur parasysh këtë, njashtu edhe te uji, por më shqetëson fakti më së shumti te anëtarët e Bordit të cilëve Qeveria ua ka zgjatur një mandat, dy ditë pa ju skaduar afati ku e pash edhe vitin ... ku me 23 dhjetor, dy ditë para skadimit Qeveria ua zgjatë mandatin 2011-ten dhe ende sot e asaj dite janë në mandat të zgjatur. Sa është kjo ligjore, me siguri Qeveria ua ka bërë ligjore, megjithëse të gjitha bordet duhet të ekzistojnë, të shkojnë. Përmes Kuvendit, përmes Kuvendi i cili e aprovon Kuvendi i

Kosovës ku jemi edhe ne dhe nënë tre, mua më intereson se raporti i një kryetari të bordit, nuk po dua me thënë me emër, ende është në akuza nga Gjykata, në procese gjyqësore dhe aty i jepen performancat e tyre se janë krejt në rregull dhe kemi kryetar të Bordit që ka pasur raste për disa... kontrata që i kanë bërë dhe këtu në fund ju jepet preferenca se është krejt në rregull dhe është ende për kryetar të Bordit dhe Kaq për fillim. Unë më shumë, megjithëse të gjithë i thanë këto kolegët e mi sa i përket te sistemi financiar, e thanë dhe atë që Qeveria diku me subvencione që ka bërë, diku i ka marrë mbi 90% krejt. Dhe se ju kanë dhënë deri 90%, ju kanë ra dikund 47 milion e 800.000 euro që ju kanë dhënë subvencione ndërmarrjeve publike, 35 milion e 500.000 janë të shfrytëzuara nga KEK-u. Këndeji kemi humbje të energjisë, këndeji subvencione merr dhe në fund del edhe me fitim ku besoj del 16 milion nëse nuk gaboj te KEK-u me fitim dhe merr subvencione, çka i duhen ato subvencione nëse e ka fitimin. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Nëse dikush tjetër prej deputetëve e donë fjalën. Ju kisha lutur zoti Sejdiu me e marrë fjalën dhe me u përgjigj në këto që u than prej deputetëve. Mundeni të dy përfaqësuesit edhe zonja Kukaj, ... për çështjet që ju mendoni se ju mendoni që duhet me i plotësuar. Ju kisha lutur më shumë me u fokusuar në përgjigje se sa në komente. Ju faleminderit, shumë.

RAMADAN SEJDIU: Fillimisht ju falënderoj te obligativi ynë se këtu na ndihmojnë se edhe nëse kemi bërë lëshime në këtë raport, në raportet tjera... Ky raport është punuar, e thash në fillim edhe nuk e di se si me u punuar ndryshe në formë tjera nëse nuk bazohemi në të dhënat e raportit të auditorit të jashtëm dhe Zyra Rregullative, do të thotë nga këto raporte ne i kemi marrë vetëm të dhënat me numra e jo fjalë.

Ishte një interesim ose pse emrat me këtë raport... të cilët veç nuk janë, nuk kanë qenë as në vitin 2012-ën. Vetëm një ta keni parasysh se ky raport është për vitin 2011, sikur t'i kishim dëgjuar emrat e njerëzve të cilët janë në vitin 2013, se në 2012 kish lindë pyetja tjetër pse me e qitur emrin e tij kur ai nuk ka përgjegjësi për këto punë, pa marrë parasysh se ish kryeshefi i PTK-së nuk është këtu, për këtë performancë ka përgjegjësi ia dhe ky shefi aktual nuk i ka përgjegjësitë.

Çështja tjetër, te rekomandimet pse ka shkuar, të bëhet trajnimi zyrtarëve për këtë ... të punëtorëve. Të ju them vetëm një gjë, në vitin 2009, vetëm dy kompani kanë ditur se çka është raporti mbi ... konsumatorëve, pse duhet me e bë këtë raport të kënaqësisë të konsumatorëve. Ju e dini që zyrat rregullative janë ata të cilët i mbron interesat e konsumatorëve, e aq më shumë kanë edhe këshilla komunale të konsumatorëve dhe me Ligjin mbi ndërmarrjet publike, në Ligjin bazik është rregullu që ndërmarrjet duhet ta punojnë nga një raport për kënaqësinë e konsumatorëve. Besomi se e kemi mbajtur një trajnim të shkurt njëditor dhe i kemi ftuar zyrtarët dhe vetëm dy-tre prej tyre kanë ditur si punohet ose çka punohet edhe ky ka qenë ajo se na e dimë edhe në radhë të parë aksionari ka obligim ndaj qytetarëve me i krijuar shërbimet publike për të cilët konsumatorët me qenë të kënaqur dhe natyrisht ato raporte tash me ndryshimin e Ligjit, është përcaktuar edhe data deri kur kanë me qenë dhe është përcaktuar që duhet me qenë edhe në ueb faqe dhe janë në ueb faqe.,

Akoma kemi mangësi te dy-tri ndërmarrjet të cilat nuk i ka qitë raportet dhe nuk dinë me i bë. Kjo ka qenë ai pse është bërë, pse me qenë ky rekomandim. Po shkojmë rend për shkak se edhe te zoti Ymeri është diçka e njëjta,...

(MYZEJENE SELMANIN: Ndërhyrje: Zoti Ramdan veç një moment. A guxoj me të ndërhyrë këtu për arsye se zotëri Shyqri Haxha dhe zonja... e cila është emëruar

RAMADAN SEJDIU: zonja Selmani veç diçka!

MYZEJENE SELMANI: Veç një moment, po dua...

KRYETARI: Zonja Selmani, dëgjo ta jap unë fjalën prapë, le ta kthen përgjigjen time...

MYZEJENE SELMANI: Këtu sa është, le të mi jap përgjigjet në pyetjet e mia.

KRYETARI: Jo, jo nuk e bëjmë u morëm vesh të gjithë deputetët i bëjnë pyetjet edhe komentet, të japim vetëm përgjigjet pastaj do ta kesh fjalën edhe për pyetje edhe për komentet tua për përgjigjet e këtyre. Tu kisha lutur, e keni fjalën dhe pastaj prapë do të...

RAMADAN SEJDIU: Zonja Sahatqija kërkoj sqarime rreth performancës financiare të Aeroportit se në 2010, ka pasur 6 milion e tash ka 200 e sa... Nga prilli, nga 9 prill 2011, kjo kompani ka kaluar ... te privati dhe të hyrat që i ka pasur nga taksat dhe operimet, për atë edhe është dashur me u qitë përndryshe as nuk krahasohen këto të hyra.

Po ju them edhe një gjë se kostot e Aeroportit, stafit janë shumë më të larta në bazë të dhënave që i kemi marrë të raporteve gjashtë mujore të pa auditume. Do të thotë ajo i ka disa mjete të deponuar aty, ka me betë në të ardhmen nëse nuk bëhet Agjenci buxhetore, ka me mbet barë e Qeverisë për shkak se stafi që punon aty edhe ata punëtorët e specializuar jashtë, ai nuk rrinë aty me pagë 800 euro, por 1600, 2000 euro. Natyrisht që ka vend për menaxhim më të mirë, menaxhim më të mirë, menaxhim parash publike, kontroll të brendshme, por është kjo.

Te kosti, pse kosti ka zvogëlim të fitimit në 1 milion e 200, sepse ka edhe zvogëlim të të hyrave për shkak se të hyrat të cilat i ka pasur në vitin 2010 të realizuara nga KEK-u, KEK-u ia ka kundërshtuar dhe nuk ia ka paguar. Këtë proces e ka zgjidhë Zyra rregullative në të mirë të kostit, por KEK-u nuk është pajtuar dhe e ka lëndën në Gjykatë Supreme, kjo ka qenë.

Te hekurudhat. Unë e thash edhe më herët, hekurudhat në bazë të Ligjit për hekurudha, është paraparë me u nda, procesi i ndarjes është bërë për atë edhe kemi, këtu në fakt janë tri hekurudha: është një hekurudhë 1 janar, 31 korrik, edhe janë dy hekurudha 1 gusht – 31.12. Çka nuk përputhet këtu. Në radhë të parë nuk po na përputhet numri i punëtorëve. Është rritur numri i punëtorëve në krahasim, pse është rritur? Ndoshta ka edhe rritje të paarsyeshme, por një prej arsyeve pse është rritur numri i stafit te këto dy kompani që kanë lindë nga hekurudha, është sepse tani më, derisa përpara një kompani ka pasur zyrtar financiar të miratueshëm për një kompani, tash duhet ... auditorët e brendshëm, do të jenë dy auditorë të brendshëm... do me thënë është shtuar stafi, më shumë stafi i logjistikës, stafi i shërbimeve të përbashkëta.

Performanca e KEK-ut. Pse KEK-u të jetë në fitim kur ka marrë subvencione, është pyetje me vend, mirëpo këtë çështje e ka parë standardi ndërkombëtar të kontabilitetit, të hyrat nga subvencioni i njohin si të hyra dhe të dhënat që janë këtu, janë nga raporti i auditorit të jashtëm i cili auditori i jashtëm i ka njehë si të hyra dhe si fitim. Sa është reale, sigurisht se nuk është reale sepse... Mirëpo e tha shumë mirë zori Ymeri se Qeveria ke obligim me i filluar shërbimet publike për qytetarët dhe në këtë rast nuk po i ndihmohet KEK-u por po i ndihmohet popullata për me krijuar shërbime, mundesh me pasur reduktime. Fatmirësisht ky subvencionim ka shkuar, është ... sa që në këtë vit kemi vetëm 13 milionë, nga 60 milionë të vitit 2009.

Në pyetjet e zotit Ymeri, fillimisht e raportoj për komunikime dhe t'ju them vetëm një gjë njësia të cilën unë e udhëheqë, është njësi që merret me Ligjin mbi ndërmarrjet publike thuhet: Njësia formohet me qëllim të mbështetjes të ministrit dhe Qeverisë për ushtrimin e autorizimeve ndaj ndërmarrjeve publike që e jep ky ligj, por ta kemi një gjë shumë të qartë se

Ligji për shoqatat tregtare dhe parimet e Qeverisë ... e përcakton një gjë të cilat shpeshherë edhe merren me media edhe ndoshta nuk kapet mirë.

Ligji mbi shoqatat... neni 133 e përcakton, thotë: nga momenti i themelimit aksionari nuk ka autorizim me menaxhuar me ndërmarrjet publike dhe ndërmarrjet publike nuk janë pjesë e Ministrisë të Zhvillimit Ekonomik. Aksionari i emëron të autorizuarit e vet, bordet e drejtorëve që t'i monitorojnë këto. Thash, a është në rregull që njësia me qenë në ministri, por është dashur me qenë nën Qeveri apo është dashur me i raportuar drejtpërdrejtë Kuvendit. Kjo është çështje të cilën e ka rregulluar Ligji, ndoshta në ditët e ardhshme do të rregullohet më mirë, por ky raport edhe Ligji e përcakton që ta përcaktojme performancën, me ju thënë të drejtën njësia si njësi nga aspekti teknik, me pasur kapacitete me e përcaktuar pse për çështje teknike e kam fjalën, e nuk ka mundur me u mbërri kjo performancë ose ajo performancë. Edhe neve ua kemi ofruar edhe juve dhe publikut një raport me të dhëna financiare, me të dhënat operative të cilat të dhëna janë të arritura dhe kredibile nga institucionet kredibile.

Ndoshta mund të thuhet e po pse atëherë kur e kemi pasur raportin të Zyrës rregullative apo të auditorit të jashtëm, është fakt që raporti i zyrës rregullative ju i keni pasur dhe i keni miratuar. Raporti i auditorit të jashtëm sigurisht se nuk i keni pasur, janë në Ueb faqe dhe nuk miratohen përveç raporteve përveç raportit të Zyrës të auditorit të përgjithshëm. Dhe, shpjegimi për reduktimin e humbjeve si është arritur, na si njësi nuk kemi kapacitete profesionale me e bë, nuk do të thotë se nuk do të kemi në të ardhmen, nuk do të pranohen, por tani për tani kapacitetet tona janë të kufizuara.

Pse kapitali aksionar 25 mijë sharron gjithkund. T'ju informojë vetëm një gjë, ndërmarrjet publike me miratimin Ligjit për ndërmarrje publike, kur kanë kaluar në institucionin vendor, UNMIK-u apo ish-AKM-ja me gjithë kërkesën tonë nuk ka dorëzuar kur certifikata fizike të aksioneve dhe Qeveria me një vendim i ka anuluar ato certifikata dhe iu kemi sugjeruar Bordit të drejtorëve të emitohen certifikatat fizike të aksioneve të tjera të bazuara në ligj. Ligji e ka përcaktuar, tash ka edhe reduktim me bë biznes me lehtë 10.000 dhe ka përcaktuar se duhet ta kenë minimumin, minimum është 25.000, tash është 10.000 dhe për secilën ndërmarrje përveç postës, kompanitë e kanë t miratuar nga një certifikatë fizike të miratuar në bartjen e shkruan ... bordeve sekretari i kompanisë dhe njësia është ruajtëse e këtyre certifikatave fizike të cilat mbahen në ... Unë e kam pasur një problem kur e kam bërë kërkesën për shëf, pse çka po të vënë shëfi, qysh? Ato janë në fakt letra të emitume por për neve kanë vlerë sepse një kopje e saj është në Agjencionin e regjistrimit të biznesit. Pse Posta i ka 5 milionë. Tash me ndarjen e Postës nuk i ka as 5, i ka 4 milion e 750, sepse pjesa tjetër i ka shkuar Postës që do të jetë e shtetit. Ka qenë e rregulluar në statut që të ketë kapital **tenderues** 5 milionë dhe certifikatën e vjetër e kemi të aksioneve certifikatën fizike prej 5 milionëve kopja që është dashtë edhe me ... që do të thotë minimumi është 25.000 euro, por... çka do të thotë kjo? Këto 5 milionë janë aksione të cilat nuk guxojnë me u prekë pa vendim të aksionarit. Ky është ai sqarimi i kësaj.

Te objektivat. Ndoshta na nuk i kemi dhënë sqarimin e mirë, por këto janë objektivat të cilat kompania në fund të vitit 2011, i ka përcaktuar për 2012-ën dhe tash kur ta bëjmë raportin 2012, na i këqyrim përveç performancës të paraqitur financiare për çka mbasi janë reduktuar dhe atij objektivi, ... me u rregulluar rrjeti i ujësjellësit në filan qyteti. Na duhemi me shkuar si me i përmbushë – nuk është përmbushë dhe rezultati i kësaj ka ardhë deri te reduktimi i humbjeve. Do të thotë janë objektiva – i dedikohen vitit 2012.

Qe hekurudhat, më duket se e dhashë pyetjen për hekurudhat pse. Subvencione, po edhe këtë zoti ... që tha Qeveria e Qeverisë, është fakt që shumë na vinë rreth neve disa obligime dhe trajnimi, na kemi me i bërë trajnimet. Natyrisht, po binë edhe shumë gjëra që funksionimi i

gjykatave, pastaj është edhe një çështje tjetër që ke – investimet, donatorët do me thënë kjo është me e sensibilizuar opinionin që të gjithë me i siguruar mjetet për investime nga donatorët. Fatmirësisht për ujësjellës thash më herët, kemi donatorë, për mbeturina nuk kemi donatorë, për hekurudha mbetem tash me Bankën Ndërkombëtare se nuk kemi.

Te humbja e ujit. Është përmendur në një raport të Zyrës të auditorit të përgjithshëm, humbja e ujit 61%, me të vërtetë është e madhe humbja prej 100 litrave 61 litër... është shume madhe edhe nga ato 39 litra që mbesin e të inkasohen 68% po bie se nga prodhimi po inkasohen veç 22 edhe tash me marr e me analizuar, nuk di se si po munden me operuar këto kompani. Përndryshe te performanca financiare e secilës, mund ta keni atje performancën ... financiare.

Shpesh na del kompania, e ka performancën pozitive – operative, por ka performancë negative financiare, pse? Nga se ne performancën financiare përfundimtare hyjnë edhe shpenzimet e amortizimit dhe të vlerësimit dhe hyrjet e shpenzimet e borxheve të këqija, në fakt sistemet e kaluara për shembull, në moment që ti e ki caktuar ka qenë fondi i caktuar, ti i ke pasur mjetet, tash nuk është në atë sistem, tash i shkruan 4 milionë shpenzime të zhvlerësimit, por ato janë veç letër të ... Me këto është paraparë që një aset kur zhvlerësohet... faktikisht kjo nuk po bartet kur te na. Dhe, shpeshherë shikoni shembull e keni Iber Lepenci, është ndërmarrje e qëndrueshme, ka sigurisht tash me shkua, kesh i ka në llogari 2 milionë, ka dal në humbje 2.800.000 për shkak se ka shpenzime aq të mëdha të zhvlerësimit nga kanalet e stërvjetësuar dhe të asetit, e ka vlerën e asetit të madhe ashtu që ajo del, ajo as nuk merr subvencione prej shtetit, as prej privateve kapitale, ka mjete të mjaftueshme edhe me investuar vet, por qe del në humbje financiare, humbje për shkak... të borxheve të këqija.

Ju e dini që vetëm KEK-u, diku pas lufte 336 milionë i ka në borxhe dhe ishte një pyetje e përfaqësuesit sigurisht të PTK-së. Me thënë të drejtën, ne e monitoruam punën e bordit dhe unë në raport nuk e pash askund se është vlerësuar bordi. Në raport shkruan se njësia e ka bërë vlerësimin vlefshmërisë së punës së bordeve për vitin 2011 dhe ky raport sipas ligjit, është i publikuar në ueb faqe, ne e kemi publikuar në ueb faqe, aty ceket çfarë performance ka, por fatkeqësisht nuk përcaktohet performanca individuale por performanca kolektive. Dhe, Objektiva apo metodologjia se si përcaktohet, si vlerësohet një bord është performanca operative, performanca financiare edhe përmbushja e kërkesave ligjore nga ligji dhe qeverisja komperative. Këto janë ato kritere që na i vlerësojmë.

Unë jam prapë i hapur dhe mendoj që është Ligj i dialektikës që çdo kundërthënie e mendimeve është me qëllim zhvillimi edhe kur nuk jemi prefekt, gjithmonë mundemi me qenë më të mirë, por kur po e mendoj se në 2009 ia kemi nisur prej zeros dhe pronarë të këtyre kanë qenë ndërkombëtarët, atje në Agjencione të regjistrimit të biznesit dhe na është dashur me i shuar holldi kompanitë, me i bë pronarë Republikën e Kosovës, në ato me filluar në kodin me bë të ri, statutin me emrin e Republikës së Kosovës, ... rregulloret, të gjitha këto me staf prej 5 vetëve që i kam pasur deri tash, tash jemi 7, jo që kam pasur shumë se nuk jam i vetëkënaqur, duhet me bërë shumë më shumë, por besoj se punëtorët e njësisë nganjëherë punojnë deri në 7,00 sepse janë detyrat përpara

(Pyetje: Sa punëtorë i keni tash?)

RAMADAN SEJDIU: Tash i kemi 7, një udhëheqës edhe 5 punëtorë

KRYETARI: Debati rreth raportit ju kisha lutur. Zoti Deshishku!

HASHIM DESHISHKU: Zoti kryetar, unë e kisha pasur vetëm edhe një pyetje zotit Sejdiu. Ku janë ata që subvencionet që i ka dhënë Qeveria e Kosovës prej 35 milionë e 500, i keni regjistruar në kontakt këtu si të hyra, apo?

RAMADAN SEJDIU: Ndërmarrjet... ndërkombëtarët të kontabilitetit, të hyrat nga... i lejojnë si të hyra.

HASHIM DESHISHKU: Pra nuk i paskemi na 16 milion fitim, por e paskemi në humbje.

RAMADAN SEJDIU: Unë gjithmonë flas në raportet e Agjencionit të jashtëm.

HASHIM DESHISHKU: Nëse regjistrohen si të hyra, ne i kemi 19 milionë e gjysmë me humbje KEK-un, nuk e kemi me fitim.

RAMADAN SEJDIU: Jo, këto i realizon si të hyra të KEK-ut.

HASHIM DESHISHKU: Subvencionet?

RAMADAN SEJDIU: Këto subvencione sipas standardit ndërkombëtar do ta ketë nga raporti i auditorit të jashtëm që mund ta gjeni në ueb faqen e KEK-ut por edhe të Njesisë tonë

KRYETARI: Okej.

HASHIM DESHISHKU: Ajo për mua sikur në fund, është me humbje për arsye se ai i ka marr tjera të gatshme mjetet pa fitim hiq, dhe i ka regjistruar si të hyra, se nuk i ka fituar askund se i ka marrë të gatshme, ia ka fal dikush dhe tash thotë që ka dal 16 milion fitim. Për mua kjo është 19 milionë e gjysmë humbje nuk është fitim, kështu që duhet të sqarohet.

E dyta, e kam edhe një pyetje: Me konsensionin që iu bë Aeroportit “Adem Jashari”, në vitin 2010, i kemi pasur 821 punëtorë, kurse në vitin 2011 thotë 159. Në deklaratat publike kam qenë gjithmonë që turqit, e shprehi ashtu në mënyrë popullore nuk do ta zvogëlojnë numrin e punëtorëve. A kemi ndonjë raport se a është zvogëluar ai numër apo është ngritur ai numri i punëtorëve, dhe ku shkuan mbi 600 punëtorë, kah shkuan ata? Dhe sa i ka Aeroporti ... punëtorë....?

RAMADAN SEJDIU: Tash unë po dua me u njoftuar me gjërat të cilat unë i posedoj. Procesin e partneritetit publiko privat e ka udhëhequr një njësi tjetër kredibile në kuadër të Ministrisë së Financave, por të dhënat që na i kemi, me të fundit kanë qenë 821 punëtorë. Në fakt, nga kontrata e konsensionimit nuk janë paraparë të kalojnë jashtë si imediateve dhe janë paraparë të kalojnë 500 e,... dhe më vonë Aeroportin e Limakut ka marr edhe një numër 100 e diçka punëtorë nga kulla ... punëtorë të Limakut, do të thotë e ko është ajo. Nëse ka diferencë ndryshimi mes asaj që e kanë plasuar në ... dhe kontratës mbi konsesionim, është sepse këta punëtorë janë marrë pas ... pas kontratës nga 6 muajve nga operimi, për ata edhe ka pasur kulla shpenzime kosto...

KRYETARI: Nga ... e lartë, mbetet me...

Unë e di që ka interesim për fjalë edhe prej shoqërisë civile, por dëgjo. Nuk e bëme, është shqyrtimi i Komisionit për raportin, kemi me bë edhe një tryezë me dëgjim publik. Ju falënderoj edhe një herë... për materialin shumë të mirë që e keni bërë dhe ju si lider pa dashur me aspak me ju kufizuar, përkundrazi prezenca e juaj ka qenë dhe do të mbetet shumë e rëndësishme por duhet me e bërë ose dëgjim publik ose ndonjë debat ose një konferencë ku kemi me e trajtuar më gjatë. Nuk besoj edhe me ... edhe me një fjalë të urët që mundemi....

Ju falënderoj shumë, por sot po e bëjmë këtë që t'ju informojmë. Bashkërisht kemi me bë një ose tryezë ose dëgjim për çështje që ne i kemi në fokus, thash jo vetëm ndërmarrjet publike por edhe disa prej rregullatorëve dhe agjencive me të cilat unë do të përballem.

Ju faleminderit, zoti Sejdiu? Shkurtimisht ju kisha lutur vetëm për çështjet që ju i dëgjuat këtu dhe po dom me e përmbyllë

RAMADAN SEJDIU: Edhe një herë po them ju falënderoj nëse kisha mundur me diskutua lidhur me momentet e GAP-it, nëse kisha mundur. Mendoj se shumë çka u tha...

KRYETARI: Si shkon, GAP-i ka bërë për neve e ju mundeni edhe këto me pas edhe ndonjë..

RAMADAN SEJDIU: Mund të kemi, megjithëse më duket e dhashë sqarimin pse ndryshojnë të hyrat e 2010 nga raporti 2010-2011 sepse janë mbështetur në raportin e auditorit të jashtëm të 2011-it, e cila i ka dy kolona 2010-2012 dhe të dhënat e fundit..... vlerësimi i punës së bordeve, na e kemi ueb faqen mund të hyni, konfliktin e interesave të dy anëtarëve të Bordit të cilët i kanë shkarkuar Qeveria...

KRYETARI: Zoti Sejdiu, nëse duhesh me e kthyer përgjigjen, duhem me ia dhënë fjalën dhe GAPI-të a me t'i sqaruar. Është një, neve na vjen shumë, janë shumë ndihmuese gjithmonë komentet që i bëjmë për raporte nga shoqëria civile, në përgjithësi për këto organizata që janë me ne...

Ato e orientojnë edhe pyetjet tona dhe qasjen tonë...

RAMADAN SEJDIU: Vetëm një lutje. GAP-i edhe... kush do që është i interesuar para se t'i bëjmë komentet te ju, por edhe për me qenë më kredibile le të kuptoj, por ne menjëherë jo me ia mbushur mendjen, por me ju dhënë fakte.

KRYETARI : Dokumenti bazë në të cilin ne orientohejmë, është Raportin që e sillni ju pastaj informacionet tona që i marrim si deputetë nga, por edhe këtu jep shumë ndihmesë.

Ju faleminderit shumë!

Nëse nuk ka diçka tjetër, ju kisha liruar. Ju faleminderit shumë që e keni përgatitur raportin dhe që keni pasur durimin dhe gatishmërinë me bë shpjegime, me dhënë përgjigje para deputetëve dhe sqarimet shitesë. Ju dëshirojmë punë të mbarë. Po ju them edhe një herë ka gatishmëri të Komisionit të gjithë anëtarëve që me punuar, me u angazhuar më shumë nga ana jonë me monitorimin e punës të ndërmarrjeve publike, do të kemi do të ballafaqohemi me ne gjatë këtij viti. Dëshirojmë që këto çështjet që janë shtruar disa herë, mos me u neglizhuar por me u trajtuar nga ana e juaj. Janë disa çështje që kanë qenë shqetësuese edhe për publikun tonë, ju e dini shumë mirë ato të cilat, prej të cilave i thatë edhe vet, i potencuan edhe deputetët. Dëshirojmë që të mos përsëriten vit pas viti lëshimet që kanë të bëjnë me menaxhmentin ose menaxhimin e këtyre ndërmarrjeve. Ju e dimë që keni pasur edhe vështirësi nga jo numri i konsiderueshëm i njerëzve, i stafit tuaj, por ju duhet të bëni gjithçka në kuadër të Ministrisë që me kapacitetet tuaja me e monitoruar dhe këto ndërmarrje me pasur sukses sa më shumë dhe me u zbatuar ligji nga ana e tyre. Edhe, po ashtu me ardhë te ne edhe me propozime konkrete nëse është e nevojshme për nisjen e procedurave për ndryshimin e ligjit.

Ju faleminderit shume dhe suksese.